ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**616-22-11624-5-1-1**
Nr i brendshëm	**616 22 176 511**

Sa i përket tenderit për: "Trajtimi i rrugëve me zhavor në fshatrat e Komunës së Prishtinës", Lot II.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Milenium Konstruction" Sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Ahmet Krasniqi" PN
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10 000
(Kodi postar)

044-155 760
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Misim Aliu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

milenium-konstruction@hotmail.com
(Adresa elektronike)

29.11.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar MILENIUM KONSTRUCTION PRISHTINË

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 21.10.2022 Data e hapjes së ofertave: 01.12.2022 Letra standarde për tenderues të eliminuar: 17.11.2023 Kërkesës për Rishqyrtim e dt. 21.11.2023 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:23.11.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

E kemi pranuar Procesverbalin e Hapjes përmes E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt.17.11.2023 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së për Lot II, ku përsëri pas rivlerësimit është rekomanduar për kontratë grupi i OE N.SH.T. "VIKTORY COM"; "Marisa" SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K., ndërsa ne jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si në vijim: *"Për pikën 1 sqarimet që i ka dërguar OE për AK nuk janë bindëse, janë sqarime të paqarta për arsye se ne kemi kërkuar siç na ka obliguar vendimi i OSHP-së për të kërkuar sqarime konform nenit 61 të LPP-së, për pozicionin 4.2. Ju përveç pozicionit që ju kemi kërkuar sqarime keni përfshirë edhe një pozicion tjetër që për AK-në përgjigjet e juaja lidhur me sqarimet e kërkuara nuk janë të argumentuara as bindëse për AK-në, përkundrazi ju përmes përgjigjes tuaj na keni mësuar se çmimi i ofruar sipas ofertës tuaj në pozicionin 4.2 është çmim jo normalisht i ulët, kurse sipas dokumenteve të prezantuara pas kërkesës për sqarime, ju vet e keni argumentuar se çmimet e tregut aktualisht janë shumë më të larta, andaj*

rrjedhimisht ju jeni eliminuar për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu jeni eliminuar edhe me vendimin e OSHP-së, nr.2023/0620 të datës 03.11.2023, ku PSH-ja ju ka klasifikuar si të pa përgjegjshëm lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe ju ka eliminuar nga pjesëmarrja ne të. Autoriteti kontraktues ka zbatuar në tërësi Vendimin e OSHP-së".

Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, fillimisht ju sqarojmë disa fakte se si është zhvilluar proceduara e këtij aktiviteti. Ne për këtë aktivitet të prokurimit përkatësisht për lot II jemi rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt.19.01.2023, pra sipas AK-së ne kemi qenë OE të përgjegjshëm në njoftimin mbi vendimin e AK-së, mirëpo çuditërisht tani pas rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit ne po eliminohemi me arsyetime krejtësisht të pa bazuara, se kinse sqarimet e dhëna nga ne gjatë fazës së rivlerësimit nuk kanë qenë bindëse dhe njëkohësisht duke ju referuar vendimit të OSHP-së nr,2023/0620 të dt.03.11.2023.

Konstatimi i lartcekur i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm për faktin se pozicioni 4.2 (furnizim me beton) dhe 4.3 (furnizim me armature) nuk punohen ndaras, por janë të ndërlidhura ndërmjet vete. Çdo person edhe atë të cilët nuk janë kompetent në fushën e ndërtimit e dijnë se armatura është e ndërlidhur me betonin, pasi që betoni përdorët në vendet ku vendoset armatura, këtë fakt e kemi sqaruar edhe në kërkesën e kaluar për rishqyrtim, mirëpo që nuk po merret parasysh nga ana e AK-së, e as nga OSHP-ja, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm.

Ne me përgjigjjet të cilat i kemi dhënë pasi që AK-ja na ka kërkuar sqarime shtesë ne e kemi sqaruar shumë qartë se kur analizohet pozicioni nr.4.2 dhe pozicioni nr.4.3, kuptohet se pozicioni nr.4.2 është domosdoshmërisht i ndërlidhur me pozicionin nr.4.3, pasi që themelet, muret dhe lëshesat betonarme të kërkuara tek pozicioni nr.4.3 nuk mund të realizohen pa pozicionin nr.4.2.
Gjatë kalkulimit të çmimeve për betonin e klasit C25/30 për themele, mure dhe lëshesa të betonarmes 1m³ kemi dhënë çmimin prej 10.00 euro, ndërsa tek vendosja në vepër e armaturës (80kg për m³) kemi bërë kalkulimin si në vijim: 80kg/m³ *3.5 €= 280€.

Kur punohen pozicionet e lartcekura së bashku, atëherë çmimi për 1 m³ beton me armaturë del të jetë 290.00 euro për m³. Megjithatë edhe përkundër këtyre fakteve ne edhe një herë po e bashkangjesim marrëveshjen ndërmjet firmës tonë dhe kompanisë furnizuese me beton dhe armaturë, të cilat garantojnë furnizimin me material për këto dy pozicione, pa marr parasysh se a do të bëhet furnizimi bashkërisht, apo edhe veç e veç për këto dy pozicione nëse është nevoja.

Duke u bazuar në kalkulimet të cilat ne i kemi bërë dhe faturat të cilat i kemi prezantuar kuptohet qartë se çmimet me të cilat kemi ofertuar ne nuk janë çmime jo normalisht të ulëta dhe sqarimet të cilat ne i kemi dhënë është dashur të merren parasysh nga ana e autoritetit kontraktues, mirëpo që një gjë e tillë nuk ka ndodhur, duke u diskriminuar ne si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.
Po ashtu duhet cekur fakti se vet fjala betonarme nënkupton beton dhe armaturë, sepse nëse do të ishte vetëm betoni atëherë do të shënohej fjala beton apo beton i thjeshtë.

Se autoriteti kontraktues na ka diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ky fakt vërtetohet edhe kur analizohet kontrata të cilën AK-ja e ka nënshkruar me OE INTEGRAL SH.P.K. për këtë aktivitet të prokurimit, përkatësisht për Lot 1. Kur analizohet paramasa e këtij OE me të cilin AK-ja ka nënshkruar kontratë, vërtetohet fakti se edhe ky OE për dy pozicionet të cilat janë të njëjta me pozicionet të cilat tani janë duke u kontestuar, ka dhënë çmimin e njëjtë tek pozicioni nr.4.2 mirëpo këtë fakt AK-ja nuk e ka marr parasysh pasi që me të njëjtin OE AK-ja ka nënshkruar kontratë.

Në këtë rast kuptohet qartë se autoriteti kontraktues për çmime të njëjta të pozicioneve të njëjta po përdor standarde të dyfishta duke nënshkruar kontratë me një OE, ndërsa neve na eliminon me arsyetimin se kinse kemi ofertuar me çmim jo normalisht të ulët.

Duhet cekur fakti se me rastin e nxjerrjes së vendimit të OSHP-së dhe ekspertizës së ekspertit shqyrtues një pretendim i tillë nuk është shqyrtuar, sepse nëse pretendimi i tillë do të ishte shqyrtuar atëherë edhe vendimi i OSHP-së do të nxjerrej ndryshe.
Në këtë aktivitet të prokurimit përkatësisht për Lot II, shihet qartë diskriminimi ndaj kompanisë tonë dhe njëkohësisht favorizimi që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë, pasi që vet AK-ja ka rekomanduar për kontratë për lot 1 dhe ka nënshkruar kontratë me të edhe pse çmimet për pozicionet e kontestuara më lartë janë të njëjta për të dy pozicionet. Mirëpo ne lot 1 rekomandohet dhe nënshkruan kontratë një OE, ndërsa ne eliminohemi me arsyetimin se kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta.

Këto janë standarde të dyfishta kundrejt kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit. Kërkojmë nga ana e AK-së që ti analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore, e sidomos pretendimin e lartcekur dhe të na sqaroj me fakte konkrete se përse një OE me çmimet e njëjta sikurse kompania jonë është rekomanduar për kontratë dhe ka nënshkruar kontratën, ndërsa ne po eliminohemi.

Gjithashtu duhet cekur fakti se për Lot 1 ku është rekomanduar për kontratë OE INTEGRAL SH.P.K., është përfunduar situacioni i parë siç e din AK-ja, ndërsa ku analizohet raporti i organit mbikëqyrës shihet qartë se pozicionet e njëjta sikurse pozicionet e kontestuara më lartë, nuk ka pasur nevojë fare të kryhen, për shkak se terreni ku do të kryhen punimet nuk është e nevojshme të kryhen pozicionet e tilla. Pra në kontratën për Lot 1 janë përfunduar punë deri më tani në vlerën 257,332.63 euro, mirëpo nuk është shpenzuar asnjë metër beton apo armaturë, për pozicionet e njëjta sikurse në rastin tonë.

(Bashkangjitur keni raportin e organit mbikëqyrës dhe dokumentet tjera përcjellëse).

Ne edhe një herë po e sqarojmë se për të vërtetuar faktin se ne jemi të gatshëm të përfundojmë këtë kontratë me çmimet me të cilat kemi ofertuar, ju sqarojmë se ne jemi në gjendje të pranojmë edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit aq sa AK-ja e sheh të arsyeshme edhe 20%, 30% apo 50% e edhe më tepër, si garancion se ne mund ta përfundojmë këtë projekt me kohë dhe në mënyrë profesionale me çmimet që ne i kemi ofruar.

Grupi i OE "Victory Com"; "Marisa" dhe "Company Murseli" shpk të rekomanduar për kontratë janë të papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:
Kur analizohet oferta e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, përkatësisht paramasa dhe parallogaria e të njëjtit kuptohet qartë se të njëjtit kanë ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta për faktin se nëse e njëjta krahasohet me objektin e kontratës shihet se ka dallime substanciale ne raport me çmimet reale të tregut.

Në lidhje me çmimet e OE të rekomanduar për kontratë autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë, ku e ka cekur si në vijim: "*Të sqaroni detajisht çmimin tuaja dhe formimin e tyre për të gjitha pozicionet, duke përfshirë: dëshmitë e çmimeve nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar, dëshmitë e doganimit, katalogët me çmime nga prodhuesit për llojet e mallrave dhe shërbimeve, marzhën e fitimit dhe mënyrën e realizimit të komplet pozicionit me çmimin e dhënë për këto pozicione, apo nëse jeni vete prodhues i këtyre produkteve një deklarate me shkrim si keni ardhur deri tek çmimi i dërguar ne ofertën tuaj për pozicionet e lartcekura*".

OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjjen e tij nuk ka dhënë asnjë detaj sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, mirëpo ka bërë vetëm një deklaratë ku e ka cekur se kinse i njëjti ka furnizime në stok dhe pjesën tjetër e prodhojnë vet. Kërkesa e AK-së ka qenë shumë e qartë se duhet të ofrohet në detaj çmimi i dhënë, duke i përfshirë këtu edhe dëshmi konkrete. I njëjti e ka cekur se kinse të njëjtit kursejnë nga marrëveshjet e favorshme për shkak të blerjes së vazhdueshme me

shumice, mirëpo është për tu habitur fakti se si autoriteti kontraktues një deklaratë të tillë e merr parasysh, mirëpo çuditërisht deklaratat tona dhe dëshmitë me fakte konkrete, të sqaruara ë mënyrë detaje nuk i ka marr fare parasysh.

Autoriteti kontraktues edhe në këtë rast po përdor standarde të dyfishta, duke ja marr parasysh sqarimet OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa sqarimet tona ku kemi prezantuar edhe dëshmi dhe marrëveshje konkrete me kompanitë prodhuese nuk i ka marr parasysh fare dhe gjithashtu kemi prezantuar edhe dokumente nga dogana ku shihet çmimi i betonit/armaturës, por që çuditërisht nuk janë marr parasysh fare.

Ne edhe një herë po e sqarojmë se çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë janë çmime manipulative, jo normalisht të ulëta dhe njëkohësisht çmime të cilat nuk përkojnë fare me çmimet e tregut, të cilat do ti sqarojmë më poshtë:

Tek pozicioni nr.1.1. dhe 1.2. – Punët Përgatitore

1.1.Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues në vend punishte.

1.2.Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet më procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e defekteve.

OE i rekomanduar për kontratë për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 1.1. dhe pozicionin 1.2. ka ofertuar me çmim prej 1.00 euro çmim njësi për secilin pozicion.

Kur kemi parasysh çmimet e tregut çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, nuk përkojnë fare me çmimet aktuale të tregut, mirëpo për çudi autoriteti kontraktues nuk i ka pasur parasysh fare këto çmime, duke e rekomanduar për kontratë.

Nga një analize dhe përllogaritje e thjeshtë, rezulton se çmimi i ofertuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është shumë herë më e ulët se çmimi mesatar dhe real i tregut, kjo vërtetohet edhe nga tabela e mëposhtme të cilën po e bashkangjesim.

1.0	Punët përgaditore					
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues në vendëpunishte.	m	1.00	1.00	0.02	2.00
1.2	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet më procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e defekteve.	m	1.00	1.00	0.01	1.00
		Gjithsej €			0.03	3.00

Tek pozicioni nr.2 (punët tokësore) nën pozicionet: 2.2 ,2.4 dhe 2.6:

2.2. Prerja (mënjanimi) i drunjtëve dhe shkurreve ekzistuese, si dhe pastrimi i terrenit me transport deri në 15 km;

2.4. Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m²;

2.6. Hapja e kanalit anësorë në formën e trapezit në tërë gjatësinë e rrugës. Dimensionet e kanalit (thellësia h=100cm, gjerësia pjesa e poshtme e kanalit bp=50cm, si dhe pjesa e sipërme e kanalit bs=150cm).

Për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 2.2. dhe pozicionin 2.4. OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 1.00 euro çmim njësi për secilin pozicion.

Ndërsa duke u bazuar në rrethana dhe çmime të besueshme e reale të tregut vendor kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk përkon fare me çmimet reale të tregut sepse nuk mund të realizohen pozicionet e

lartcekura me çmim prej 1 euro pasi që të njëjtat siç edhe e cekëm nuk janë fare në harmoni me çmimet e tregut dhe janë çmime jo normalisht të ulëta. Minimumi i çmimit për pozicionin 2.4. në treg sillet rreth 2.00 euro, andaj është e pamundshme që të përfundohet pozicioni i tillë me çmimin më të cilin ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta dhe i njëjti OE nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

2.2	Prerja (menjanimi) i drunjeve dhe shkurreve ekzistuese, si dhe pastrimi I terenit me transport deri në 15 km;	m'	1	1.00	0.01	1.00
2.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m²	m²	1	1.00	0.04	4.00
2.6	Hapja e kanalit anësorë ne formen e trapezit ne tere gjatesin e rruges. Dimensionet e kanalit (thellesia h=100cm, gjeresia pjesa e poshtme e kanalit bp=50cm, si dhe pjesa e siperme e kanalit bs=150cm).	m'	1	1.00	0.02	2.00

Tek pozicioni 3 (punët e zhavorrit) nën pozicioni 3.2, 3.3 & 3.4.

3.2. Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te pastër dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmërisë Mt=50 Mpa., 0- 100 mm

3.3. Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te pastër dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmërisë Mt=60 Mpa. 0- 63 mm

3.4. Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te pastër dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmërisë Mt=70 Mpa., 0- 31 mm

Për realizimin e punimeve te pozicionit nr. 3.2. ka ofertuar me çmimin prej 4.50 euro për m³, ndërsa për realizimin e punimeve të pozicionit 3.3 dhe 3.4 ka ofertuar me çmimin prej 8.00 euro për m³.

Ndërsa duke u bazuar në rrethana dhe çmime të besueshme e reale të tregut vendor kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk korrespodon fare me çmime reale te tregut sepse në treg nuk ka çmim prej 4.50 euro dhe 8.00 euro për realizimin e këtyre pozicioneve. Sa për sqarim minimumi i blerjes së zhavorrit te këtyre karakteristikave është 8 euro për m³ tek gurëthyesi për ta blerë, ndërsa pastaj pasi të kalkulohet transporti, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorrit, çmimi minimal real duhet të jetë së paku 11.00 euro për m³.

3.2	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te paster dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmerise Mt=50 Mpa. , 0- 100 mm	m³	1.00	4.50
3.3	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te paster dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmerise Mt=60 Mpa. , 0- 63 mm	m³	1.00	8.00
3.4	Furnizimi, transporti përpunimi i tamponit me gurë të thyer të fraksinuar te paster dhe ngjeshja e tij me modul te ngjeshmerise Mt=70 Mpa. , 0- 31 mm	m³	1.00	8.00

Pozicioni 4 (punët e betonit) nën pozicioni 4.1.

4.1. Furnizimi, transporti kallëpimi vendosja kompaktimi i betonit të thjeshtë C 10/16 si bazë për elemente mbrojtës.

OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me pozicionin e lartcekur ka ofertuar me çmim manipulativ prej 35.00 euro çmim njësi për pozicion.

Kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk korrespodon fare me çmime reale të tregut pasi që çmimi për m3 i betonit sipas indeksit te çmimeve të publikuara nga AQP dhe KRPP sillet afro 70 deri 90 euro, sepse nuk ka çmim prej 35.00 euro në realizimin e këtij pozicioni me çmimet e tregut.

Pra, nga një analize dhe përllogaritje e thjeshte, rezulton se çmimi i ofertuar nga ana e OE në fjalë është shumëfish herë më e ulët se çmimi mesatar e real i tregut.

Furnizimi, transporti kallepimi vendosja kompaktimi I betonit të thjesht C 10/16 si bazë per elemente mbrojtës.	m³	1	35.00	0.04	0.10

Pozicioni 5 (punët e lëshesave) nën pozicioni 5.1.
5.1. Furnizimi , transporti dhe punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikëqyrja. Në çmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (në çmim të llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor).
OE i rekomanduar për kontratë për realizimin e punimeve të pozicionit nr. 5.1. ka ofertuar me çmim manipulues prej 10.00 euro – 20.00 euro për m'.
Ndërsa duke u bazuar në rrethana dhe çmime të besueshme e reale të tregut vendor kostoja mesatare për kryerjen e kësaj pune nuk korrespodon me çmime reale të tregut sepse nuk ka çmim 10.00-20.00 euro ne realizimin e këtyre pozicioneve te cimet e tregut.
Pra, nga një analize dhe përllogaritje e thjeshtë, rezulton se çmimi i ofertuar nga ana e OE në fjalë është shume me i ulët se çmimi mesatar e real i tregut.

5.1	Furnizimi , transporti dhe punimi i lëshësave, pjëseve kaluese dhe kanaleve te mbyllura ne disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna nga mbikqyrja. Në çmim është llogaritur edhe hapja e kanalit, (ne qmim te llogaritet mbulimi me rërë dhe zhavor)			
	Gyp prej betoni të armuar Ø 1200 mm	m'	1	20.00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 1000 mm	m'	1	20.00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 800 mm	m'	1	15.00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 600 mm	m'	1	15.00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 500 mm	m'	1	10.00
	Gyp prej betoni të armuar Ø 400 mm	m'	1	20.00

Duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, mirëpo çuditërisht autoriteti kontaktues nuk i ka marr parasysh fare këto fakte, pasi që e ka rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti nuk ka dhënë përgjigjje të detajuar në sqarimet e tij.

Përderisa AK-ja i ka kërkuar sqarime në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo i njëjti nuk ka dhënë përgjigjje të detajuar të mbështetur në dëshmi dhe fakte konkrete mirëpo ka dhënë vetëm një deklaratë, ndërsa në tjetrën anë neve na ka kërkuar sqarime shtesë dhe pasi që i kemi dhënë përgjigjjet e detajuara me dëshmi konkrete na ka eliminuar me arsyetimin se kinse përgjigjjet tona nuk janë bindëse. Në këtë rast shihen qartë standardet e dyfishta që AK-ja i ka përdorur për këtë aktivitet të prokurimit, në raport me çmimet me të cilat kemi ofertuar ne dhe çmimet me të cila ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë.

Në bazë të të gjitha fakteve dhe provave të paraqitura, rezulton se tenderi i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë përbën tender jo-normalisht te ulet për faktin se është krijuar mbi bazën e çmimeve manipuluese, të ulëta me dallim disa herë nën nivelin e çmimeve reale të tregut dhe burimeve të besueshme siç janë çmimet e publikuara nga Zyra e Statistikave te Kosovës dhe/ose çmimet tjera indikative zyrtare (të tilla si zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike).
Andaj kjo ofertë e cila si e tillë ka dallim substancial me çmimet reale të tregut rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës dhe kufizon/shtrembëron konkurrencën e lirë të OE ankues dhe tenderuesve tjerë ne raport me ofertimet të cilat janë në pajtueshmëri me rregullat dhe çmimet reale të tregut.
Kërkojmë edhe një herë nga ana e OSHP-së ti analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore dhe të kthej lëndën në rivlerësim, me qëllim të trajtohen të gjithë OE në mënyrë të barabartë, sepse në të kundërtën (pa dashur që një gjë e tillë të merret si kërcënim), ne nuk do të ndalemi me ankesa edhe në instancat më të larta.

Ne me dt.23.11.2023 kemi pranuar vendimin e AK-së për kërkesën për rishqyrtim, ku e njëjta e ka hedhur si të palejuar të njëjtën dhe është arsyetuar se ne jemi palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit.

E njëjta i është referuar vendimit të OSHP-së nr.2023/0620, mirëpo ju sqarojmë se vendimi të cilit i është referuar autoriteti kontraktues nuk i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tona ankimore, përkatësisht pretendimin në lidhje me kontratën e nënshkruar për Lot 1, ku OE i cili e kishte nënshkruar kontratën kishte ofertuar për pozicionet e njëjta me çmime sikurse çmimet tona. Pra në këtë rast nuk është shqyrtuar pretendimi ankimor në lidhje me rastet e njëjta, pra ku për çmime të njëjta një OE ka nënshkruar kontratë, ndërsa ne për Lot 2 po eliminohemi me arsyetimin se çmimet janë jo normalisht të ulëta.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj për kërkesën tonë për rishqyrtim, nuk i ka analizuar fare faktet dhe dëshmitë tona, mirëpo vetëm na ka cilësuar palë pa interes me arsyetimin se pas vendimit të OSHP-së nuk mund të dëshmoni asnjë interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit dhe për pasojë nuk jeni palë e interesuar, duke ju referuar nenit 4 të LPP-së.
E njëjta po ashtu i është referuar edhe nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 59 të RRPP, ku e ka cekur se vetëm palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë për rishqyrtim.

Këto arsyetime të AK-së janë të paqëndrueshme dhe njëkohësisht tendencioze kundrejt kompanisë tonë, sepse e njëjta me qëllimin që të mos i shqyrtoj pretendimet tona ankimore, po mundohet qëllimisht të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit me një arsyetim krejtësisht absurd.
Ne në këtë aktivitet të prokurimit kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim konform nenit 108/A paragrafi 1 ku specifikohet qartë *"**1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues**. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit".*

Sa i përket referimit të AK-së tek neni 4 se kinse ne nuk jemi palë me interes, ju sqarojmë se edhe ky pretendim i të njëjtës është i paqëndrueshëm për faktin se ne në kërkesë për rishqyrtim e kemi treguar qartë me fakte konkrete se në këtë aktivitet të prokurimit po përdoren standarde të dyfishta ndërmjet kompanive.
Fakti se ne jemi palë me interes apo jo as nuk duhet të diskutohet për shkak që ne po parashtrojmë kërkesa për rishqyrtim për herë të dytë, ndërsa autoriteti kontraktues në mënyra krejtësisht diskriminuese po devijon nga pretendimet tona ankimore, duke mos i shqyrtuar fare.

Pra në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi eliminuar nga AK-ja me arsyetimin se kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta edhe pse përmes sqarimeve i kemi prezantuar dëshmitë konkrete me fatura se si kemi ardh në përfundim të çmimit me të cilin kemi ofertuar, mirëpo autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh fare këto fakte dhe na ka eliminuar.
Ndërsa në anën tjetër me vendim të OSHP-së AK-ja është detyruar të kërkoj sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë dhe një gjë të tillë e ka bërë, mirëpo edhe pse OE i rekomanduar për kontratë si përgjigjje ka prezantuar vetëm një deklaratë në të cilën nuk ka asnjë dëshmi se si ka ardh i njëjti OE deri tek çmimi me të cilin ka ofertuar, AK-ja e ka rekomanduar përsëri për kontratë.

Duke mos i shqyrtuar pretendimet tona ankimore, AK-ja me qëllim të favorizoj OE të rekomanduar për kontratë ka vepruar në këtë mënyrë duke i shkelur dispozitat e nenit 108/A të LPP-së.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për të hedhur si të palejuar kërkesën tonë për rishqyrtim, është i pa bazuar dhe njëkohësisht është vendim i cili e favorizon haptas OE të rekomanduar për kontratë.

Andaj kërkojmë nga ana e ekspertit shqyrtues dhe panelit shqyrtues të OSHP-së që ti analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore, kontratën për Lot 1 dhe pretendimet tona për OE të rekomanduar për kontratë, pasi që kundrejt kompanisë tonë po përdoren standarde të dyfishta në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë.

Pa dashur që këtë fjali ta merrni si kërcënim, ju sqarojmë se nëse pretendimet tona nuk do të merren parasysh ne jemi të detyruar të vazhdojmë me ankesa edhe në instancat tjera më të larta.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Milenium Konstruction" Sh.p.k**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për **Llot II** dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesës në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*